

Siguri

Armatim i fshehur në valixhe, dyshohet se po dërgohej drejt Gjermanisë – tre persona në arrati



Foto ilustruese



Sinjali.com

24 Qershor 2026 10:25



Një rast i rëndë që lidhet me armë dhe municion është zbuluar nga organet e rendit në Podujevë, ku janë sekuestruar disa armë të gjata, pistoletat dhe një sasi e konsiderueshme municioni, ndërsa tre persona po kërkohen nga autoritetet.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se rasti ka dalë në dritë pas informacioneve operative të siguruar nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda (DHKOKR), sipas të cilave në një agjenci turistike ndodheshin dy valixhe të dyshimta.

Pas verifikimeve të kryera në depon e agjencisë, hetuesit kanë konstatuar se brenda valixheve ishte fshehur armatim. Më pas, me autorizim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, janë zhvilluar veprime të shpejta hetimore dhe bastisje në lokacione të ndryshme.

Sipas burimeve, si të dyshuar janë identifikuar L.M., rreth 26-vjeçar, R.K. rreth 28 vjeçar dhe A.M. rreth 29 vjeçar, të cilët dyshohet se kanë qenë të përfshirë në organizimin dhe transportimin e armatimit. Megjithatë, ata nuk janë hasur në shtëpitë e tyre gjatë operacionit policor dhe aktualisht ndodhen në arrati.

Ndërkohë, pronari dhe menaxheri i agjencisë turistike janë shoqëruar në zyrat e DHKOKR-së në cilësinë e dëshmitarëve dhe janë intervistuar lidhur me rastin.

Sipas informacioneve të siguruar nga hetimet, ekziston dyshimi se destinacioni përfundimtar i armatimit ishte Gjermania, përkatësisht qyteti i Shtutgartit. Hetuesit dyshojnë se njëri nga të dyshuarit kishte rol të veçantë në pritjen dhe pranimin e valixheve me armë sapo ato të arrinin në Gjermani.

Gjatë kontrollit të valixheve janë sekuestruar:

5 armë të gjata të llojeve të ndryshme, përfshirë disa AK-47;

2 pistoletat të markës Glock me 18 fishekë të kalibrit 9 mm;

8 karikatorë për armë të gjata AK-47;

20 fishekë për pushkë gjuetie;

106 fishekë të kalibrit 7.62×39 mm.

Lidhur me rastin është iniciuar procedurë penale për veprën "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse", ndërsa hetimet po vazhdojnë në koordinim me Prokurorinë Speciale.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/


armatim

valixhe

Gjermania]

Tre persona në arrati

Të tjera:




Drejtori i Policisë: Përgatitjet për sulmin terrorist u bënë katër ditë përpara në një poligon ...

Siguri



Rusia pretendon fitore në fushëbetejë, Ukraina në pritje të armatimit

Botë



Sulm në një lokal nate në Norvegji, dy të vdekur dhe 14 të plagosur

Evropë




Britania demanton serbët për furnizimin e Kosovës me armë

Rajon



Mehaj: Ushtria e Kosovës vazhdon të furnizohet me armatim, investimi është obligi...

Siguri



Kurti për televizionin portugez: Armatimi që Rusia ia jep Serbisë nuk është për para, por...

Politikë



Kompania gjermane e armatimit dërgon 50 tanke të përdorur në Ukrainë

Botë



Qytetarët e Sarajevës po armatosen masivisht pas luftës në Ukrainë – përfshihen edhe...

Rajon

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera

